

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rusia dhe Kina vendosin veton ndaj SHBA-së në OKB, bllokohet monitorimi i sanksioneve ndaj Iranit
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/18/rusia-dhe-kina-vendosin-veton-ndaj-shba-se-ne-okb-bllokohet-monitorimi-i-sanksioneve-ndaj-iranit/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:28:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 06:27:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	00fe2aa725efbba6271334a36c411fc8c67b043813c70c0a0200ce250ff1e36f
TEKSTI	196c06b77f95cc0080c67df4e7f7ea4d2334bb8e621dd567075d3d045ab0500d
PAMJA	28bff46a08a906eaa9ad9a325dfa5d64d26c841b282a191cc5faa68e1044255

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	59e44ec05c35e2f80883eb039458139c946bf32fdb00ac17670bbfb06467f6e5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/59e44ec05c35e2f80883eb039458139c946bf32fdb00ac17670bbfb06467f6e5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > BOTA

Rusia dhe Kina vendosin veton ndaj SHBA-së në OKB, bllokohet monitorimi i sanksioneve ndaj Iranit

08:27 : 18/09/2026 në BOTA



Rusia dhe Kina kanë vënë veton ndaj një rezolute të Shteteve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, e cila synonte zgjatjen me një vit të mandatit të një paneli ekspertësh që monitoronte zbatimin e sanksioneve ndaj Iranit për programin e tij bërthamor.

Rezoluta u rrëzua me 11 vota kundër 2, ndërsa Somalia dhe Pakistani abstenuan. Vetoja e Rusisë dhe Kinës nuk i heq sanksionet ndaj Iranit, por i jep fund mekanizmit të pavarur të ekspertëve që kontrollonte zbatimin e tyre.

Sanksionet e OKB-së u rikthyen më 27 shtator të vitit të kaluar përmes mekanizmit të njohur si "snapback", pjesë e marrëveshjes bërthamore të vitit 2015. Ato përfshijnë ngrirjen e pasurive iraniane jashtë vendit, kufizime për marrëveshjet e armëve dhe masa kundër zhvillimit të programit iranian të raketave balistike.

Franca, Gjermania dhe Britania e Madhe aktivizuan mekanizmin "snapback", duke rikthyer edhe komitetin e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit dhe autorizuar panelin e ekspertëve për të kontrolluar zbatimin e masave. Rusia dhe Kina kishin kundërshtuar votimin e rezolutës amerikane. Ambasadori rus në OKB, Vassily Nebenzia, tha se rikthimi i sanksioneve ishte i paligjshëm dhe se për këtë arsye edhe zgjatja e mandatit të panelit nuk kishte bazë ligjore.

Lexo edhe:

["Nuk kam lobuar për veten"/ Berisha tregon prapaskenat e heqjes së ndalimit në SHBA](#)

[A po përgatitet Polonia për luftë me Rusinë?](#)

Nga ana tjetër, Franca e konsideron zbatimin e sanksioneve një mjet të rëndësishëm për të nxitur Iranin të respektojë detyrimet e tij bërthamore. Franca, Gjermania, Britania e Madhe dhe SHBA-ja po shqyrtojnë edhe mundësinë e krijimit të një ekipi të ri për monitorimin e sanksioneve.

Votimi në OKB vjen në një kohë kur administrata amerikane po shton presionin ekonomik ndaj Iranit. Të enjten, Departamenti amerikan i Thesarit dhe Departamenti i Shtetit njoftuan masa ndaj dy kompanive dhe tre personave që, sipas SHBA-së, kanë ndihmuar subjektet

TË GJITHA



Rusia dhe Kina vendosin veton ndaj SHBA-së në OKB, bllokohet monitorimi i sanksioneve ndaj Iranit

08:27 : 18/09/2026



BE kërkon kufizime më të rrepta moshe për rrjetet sociale

08:19 : 18/09/2026



Këmbimi valutor 18 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja

08:14 : 18/09/2026



Nga Lazarati të Kanadaja: Si po ndryshon trafikimi i kanabisit në Shqipëri

08:08 : 18/09/2026



Kthjellime dhe vranësira kalimtare, në disa zona priten reshje të dobëta shiu

08:05 : 18/09/2026



Horoskopi për ditën e premte, 18 Shtator 2026

03:00 : 17/09/2026



Mbyllet protesta e 110-të kundër Ramës në Tiranë

22:56 : 17/09/2026

iraniane te snmangin sanksionet une te kene qasje te paigjsnime ne sistemin financiar ndërkombëtar.

Misioni i Iranit në OKB falënderoi Rusinë dhe Kinën për veton, duke akuzuar SHBA-në dhe aleatët e saj se po përdorin Këshillin e Sigurimit për qëllime politike. Ndërkohë, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike ka deklaruar se nuk ka qenë në gjendje të verifikojë plotësisht gjendjen e rezervave të uraniumit të pasuruar të Iranit që prej sulmeve amerikane dhe izraelite ndaj objekteve bërthamore iraniane në qershor 2025.

Sipas të dhënave të fundit të agjencisë, Irani kishte rreth 440.9 kilogramë uranium të pasuruar deri në 60 për qind. Pasurimi në 60 për qind është shumë më i lartë se niveli i zakonshëm për përdorime civile, ndërsa uraniumi i pasuruar në rreth 90 për qind konsiderohet i përshtatshëm për përdorim në armë bërthamore.

SHBA-ja argumentoi se mbyllja e panelit të ekspertëve krijon një boshllëk në monitorimin e sanksioneve dhe e bën më të vështirë dokumentimin e shkeljeve. Rusia dhe Kina, ndërkohë, e kundërshtojnë këtë qasje dhe thonë se mekanizmi i sanksioneve është i paligjshëm.

Etiketa: kine OKB Rusi SHBA

Lajme të lidhura



"Nuk kam lobuar për veten"/ Berisha tregon prapaskenat e heqjes së ndalimit në SHBA

21:54 : 17/09/2026



A po përgatitet Polonia për luftë me Rusinë?

18:11 : 17/09/2026



Lufta tregtare, BE-ja i kërkon Kinës të kufizojë eksportet e makinave hibride

10:05 : 17/09/2026



Vritet në Ukrainë gjenerali i shpallur "Hero i Rusisë"

21:13 : 16/09/2026



Uashingtoni zbuloi armët në orbitë, Kina kërkon çmilitarizimin e hapësirës

16:30 : 16/09/2026



"E respektojmë aktgjykimin"/ SHBA reagon pas vendimit të Hagës: Të shmanget retorika nxitëse

15:52 : 16/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

